

RenovAID: Praktikë e mira nga Polonia dhe Hungaria mbështesin rinovimin e ndërtesave në vendet që aspirojnë anëtarësimin në BE

Projekti RenovAID, i cili nisur në nëntor të vitit 2023, po i afrohet përfundimit. Në ngjarjen përmbyllëse të projektit, partnerët prezantuan rezultatet e arritura dhe diskutuan mbi transferimin e praktikave të mira në fushën e rinovimit të ndërtesave midis vendeve dhe qyteteve të binjakëzuara. Kjo do të thotë se praktikë e zhvilluara në Poloni dhe Hungari mund të përdoren nga vendet që aspirojnë anëtarësimin në Bashkimin Evropian, si Shqipëria, Kosova, Ukraina dhe Moldavia.

Gjatë dy viteve të fundit, partnerë nga Polonia, Hungaria, Shqipëria dhe Kosova kanë përgatitur analiza dhe raporte mbi politikën dhe praktikën në fushën e efikasitetit të energjisë në ndërtesa në Shqipëri dhe Kosovë; ata kanë zhvilluar trajnime, workshope dhe një vizitë studimore për administratat publike dhe aktorët e interesuar, përfshirë aktivitete që mbështesin krijimin e qendrave për shërbime të integruara për rinovimin e ndërtesave. Projekti përfshiu gjithashtu përgatitjen e materialeve edukative dhe filmave për rritjen e ndërgjegjësisë mbi efikasitetin e energjisë.

Sipas Krzysztof Fal, Drejtor i Zhvillimit të Programeve në WiseEuropa - ky projekt na mësoi dhe demonstroi fuqishëm se bashkëpunimi midis qyteteve mund të nxisë ndryshim real në arritjen e objektivave të politikave klimatike. Edhe nëse një vend apo qytet nuk është ende shumë i avancuar apo lider në zbatimin e këtyre politikave, duke u bazuar në përvojat e tij dhe duke nxitur bashkëpunimin dhe shkëmbimin e pikëpamjeve dhe ekspertizës midis qyteteve, mund të zhvillojmë zgjidhje efektive që adresojnë të gjitha sfidat kryesore.

RenovAID trajtoi çështjen e përparimit modest në përmirësimin e efikasitetit të energjisë në ndërtesat e Kosovës dhe Shqipërisë duke ofruar mbështetje strukturore në disa nivele. Llogika bazë e projektit ishte rëndësia e efikasitetit të energjisë në tranzicionin energjetik, pasi ajo adreson njëkohësisht dimensionet mjedisore, sociale, ekonomike dhe të sigurisë energjetike. Meqë në të dy vendet përfituese mungon kuadri i duhur politik, RenovAID synoi të ofrojë mbështetje gjithëpërfshirëse për këtë aspekt të tranzicionit energjetik. Projekti u zbatua nga WiseEuropa (Poloni), Energiaklub (Hungari), Mileukontakt (Shqipëri), Balkan Green Foundation dhe Instituti për Politika Zhvillimore (Kosovë).

Ky projekt është pjesë e Nismës Evropiane për Klimën (EUKI), e Ministrisë Federale Gjermane për Mjedisin, Veprimin Klimatik, Ruajtjen e Natyrës dhe Sigurinë Bërthamore (BMUKN).

Supported by:



Federal Ministry
for the Environment, Climate Action,
Nature Conservation and Nuclear Safety



European
Climate Initiative
EUKI



ENERGIACLUB
CLIMATE POLICY INSTITUTE
APPLIED COMMUNICATIONS

on the basis of a decision
by the German Bundestag